



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| | | | |
|---|------------|-------------------|------------------|
| Pranuar - Përdhëro Më/Dana 15-07-2024 vit/qor | | | |
| Nr. i organit Org. broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednos |
| 01 | 060/01 | | 965 |



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të Nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011; Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e VII të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë: **22.07.2024**, (e Hanë) në ora **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në zyrën e konferencave të objektit të vjetër të Komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-qershor 2024
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës se Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2025.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik draft rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2025.
5. Informat nga DKA-ja, zhvillimi i procesit edukativoarsimor dhe përfundimi i gjysmëvjetorit të dytë për vitin shkollor 2023-2024.

Viti, më 15.07.2024

Me respekt!
Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E GJASHTË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **21.06.2024 (e Premte)**, në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Illir Zuka, z.Ramadan Deliu, z.Jakup Demiri, znj.Majlinda Shabani, znj.Zyrafete Rama, znj.Zejnepe Osmani. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se ka anëtarë për kourum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Përshëndetje për nënkryetarin e komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje, mirë se keni ardhur në mbledhjen e gjashtë të rregullt të KPF-së për këtë vitë. Gjatë kësaj periudhe mesa e di nuk na ka ardhë asnjë konfirmim prej seances së kalume, kemi kërku dhe konfirmimin e ligjshmërisë së votimit që kemi bë në fund të shfuqizimit të një akti që patem, që mbetem me vota 10 për 1 kundër, abstenim nuk pat dhe 6 deklaruan që nuk votojnë. Tash Zyra e MAPL-së në bazë të bisedave thotë që, duhet me kalu, se ata kanë qenë prezent, llogariten abstenim, ndërsa ne e kemi bë kërkesën me shkrim me na e kthy, se pa e kthy për neve ajo është që ka dështu ai votim. Ende nuk ka, e kanë kthy, kanë thanë që e kthejnë. E di që keni pas probleme me e-mail, por Fatlumi ja u ka dërgu linkun dhe në viber, që besoj është dhe aty një qasje e lehtë për material. Pra, materialin e keni marrë me kohë, para se me hy në rend të ditës hapim diskutim.

z.Ramadan Deliu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Parzit që the që, e kemi qu për atë anulimin e kësaj pikës për shujtat. Ju më së pari vet e keni qu gabim, se ne nuk kemi marrë hiq pjesë në votim. Ju keni shkru që kanë abstenu, por nuk kanë marrë pjesë në votim. Dhe e dyta, ne jemi deklaruar që nuk marrim pjesë në votim hiq. Dhe një kërkesë e kam, këtë vendimin e 2016-ës që po e lypin për një bahqe me qenë fermer. Këtë kisha propozu që në seancën tjetër me pru dhe me ndryshu këtë rregullore.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Në seancë të fundit unë kam kërku deklarimin e shefit të juaj. Ai ka thanë nuk marrim pjesë në votim. Unë e kam ditë që vjen qekjo çështje. Heren e kalume kqyre, ata do kanë qu gishtin që janë abstenim, e kemi përcjell, është incizimi, i ka kalu 14 votat që kan votu. D.m.th është sakt që disa kanë abstenu, disa nuk kanë votu hiq, nuk kan marrë pjesë, mirëpo në momentin që nuk deklarohesh. Kësi hovi është deklaruar, qekjo na u ka përzi, se shpesh nuk e qonë doren, shkon abstenim, po në momentin që deklarohesh që nuk marrë pjesë në votim, atëhere na e kanë komplikuar këtë çështje që kemi kërku me insisitimin e nënkryetarit, sepse këtë e kam marrë si të kryme, se e kam pas në asociacion të komunave, e kemi diskutu këtë çështje dhe e kanë këtë problem disa komuna që nuk mujnë me i bë gjysmën e votave me votu. Rrinë shembull aty në kuvend krejt edhe krejt vendimet i kanë pezull, nuk i kan kalu.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Mua më ka shty se, unë si komunë nuk kam dashtë me ra poshtë, se vet prezenca në literatur juridike mësohet se e bënë kuorumin, se pa e bë kuorumin ti nuk guxon me qitë në votim. Kryesuesi kuorumin e ka pas, sepse i ka pas 17 prezent. Nga 17, 6 janë deklaruar se nuk marrin pjesë në votim, juridikisht nuk është e shkrume që mund me thanë qeshtu, por vetë nënkupton, përdoret analogjia, ku 17 ja kanë bërë kuorumin i ka prezent, dhe shumica e thjeshtë 10 kanë votu për, 1 abstenim, 6 nuk kan marrë pjesë

me të konsultohem se është edhe ky jurist, më tha nuk e di. Dhe ky e ka thirrë, unë kam bisedu me të dhe ka thanë që, gjithçka është okej. Prandaj e kam thirrë kryesuesin i kam tregu, dhe ka thanë më së miri është me ju drejtu me shkrim, për shkak të situatës së krijuar në kuvend dhe i kam thanë, po, drejtoju me shkrim. Ai është i obligum me ta kthi që me shti në dosje me pas argument se ka kalu.

z.Illir Zuka: Zgjedhja e presidentes është bërë në këtë mënyrë. Ne e dimë që LDK-ja ka nejt e ka bërë kuorumin, por një pjesë e tyre nuk ka marrë pjesë në votim, po janë llogaritë pjesë e kuorunit.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Unë i kam përcjellë në kuvend, nuk e voton PDK dhe LDK, nuk i kalon 61 që votojnë.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Ka vendime që lypet 50 plus 1.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Tash votimi i 51, tash në sallë janë mbi 61, por nuk po votojnë. Momentin që po votojn 60 ose 59 ajo nuk po kalon.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Janë disa vendime, p.sh.: Statuti i komunës për me të kalu në komunë duhet 2 e 3 jo, prezent ti duhesh mi pas 18 për. Vendimet tjera mirren me shumicë të thjeshtë.

z.Illir Zuka: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! E kam bërë një kërkesë. Para disa seancave për shenjzimin në rrugë kryesore në Pozheran. Unë e di që ajo rrugë është rrugë magjistrale, por shumë here ka intervenu dhe Komuna e Vitisë, d.m.th për shkak të nxënësve ato vijat e këmbësorëve janë fshij krejt. Edhe një kërkesë tjetër vazhdoj ta bëjë, nga "Lagjja e Muhaxherëve" për kanalin që nuk po intervenohet edhe këtë vit. D.m.th me hektar të tërë i ka marrë pjesa e kanalizimit që delë e vjen prej Dardanisë e Sllatinës dhe komplet ajo tjetra edhe kur nuk ka vërshime krejt kanalizimet dalin aty. D.m.th ajo pjesë nuk kanë mujtë asnjë ari me marr ose me kullosë. Dhe një kërkesë tjetër. E di që ja ka bërë ai djali edhe kryesuesit. Dje më ka taku personalisht edhe mua, është një familje në Tërpezë, është tu e pas një problem të madh, d.m.th një familje që jeton në Ferizaj ja ka lanë 40 ose 50 koshere bletë afer atij, pa marrë parasysh që ai e ka tokën e vet. Po ti nuk mundesh me rreziku një familje, dhe ai e kish një anëtar të familjes me alergji. E di çka d.m.th se jam vet alergjik prej bletave dhe ai e ka fitu me gjyqë dhe ende nuk është ndërmarr asgjë, nuk ja kanë hjek. D.m.th është jashtëzakonisht rrezik, kur e dimë që në këtë kohë sa dalin bletat, dhe unë po besoj që ju si institucione komunale duhet me intervenu me bë diçka, se familjen nuk bënë me blloku në shpi. Ata thanë tanë ditën nuk guxojmë me dalë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Unë i tregova edhe atij që me ju drejtu inspeksionit, se kuvendi nuk mundet me bë asgjë për këtë çështje.

z.Jakup Demiri: Unë po e diskutoj këtu. Pardje më ka thirrë një djalë në telefon, më tha ku je, më pyeti a je shumë i nxanun që me ardh deri ku është tu ndertu një objekt. I thash a ki ndonjë telashe a çka ki, se unë nuk jam polic. Jo tha, vetëm jam një qytetar, veç hajde kqyre qysh është tu ndertu. I thash thirri inspektorët, por kur shkova e pash një gjendje. Këtë betonin që e marrshin prej poshtit, e marrshin me kant dhe me singjir, kurrfarë sigurie. Ai i kish pa prej veture se ishte nje gurbetgji, por dua ta kem anonim. Më tha nëse nuk ndërmarrin diçka ka me i postu, edhe unë e pashë që ishte shumë keq.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka për debat dhe unë po e ngriti një çështje. Nënkyetar, për një trotuar në Smirë është nisë para zgjedhjeve në 2020, ja ku e ke fotografinë, ma dërgoj një person, janë pak 2-3 vende me ndërhy dhe mbyllen ato probleme. Kam mujtë me ngritë këtë dhe në kuvend, por nuk dua ta ngris, po në të shkon ne ti përfundon ato vende që kanë mbetë.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Shenjzimi, ta shohim a kemi kontratë që me intervenu aty. Është e vëretë që ne kemi intervenu 2-3 here, edhe pse është aspekti i magjistrales. Kanalin qyshë di i ka kalu procedurat e tenderimit, duhet me fillu. Trajtimin e rastit të bletave. E di që Naim Pira është marrë nja 5-6 muaj me atë rast, unë e kam pas ditë që ka përfundu ajo çështje, se ky bletari ka kërku. Po i heku nëse ma siguron do pronë. Për më të siguru komuna ti duhesh me apliku. Kur i qetë në dhanie ne shfrytezim dhe e merrë aty ku të konvenon, por tash nuk të thotë unë ta heki prej shpisë po ta siguroj një vend, se aspekti ligjor nuk e lejon, është një realitet në rastë se e marrim këto bletë nuk jan tash qe 100 vjet jan bab e babgjysh, se është fjala për në oborr të Adem Muratit të ndjerë, që thojke i kem diku që nga viti 1900, rregullisht i ka pas aty dhe ka jetu aty, por tash nuk jeton aty, jeton në Ferizaj, tash merret djali tij a nuk e di, sepse nuk i njof më hiq, megjithatë duhet me kqyrë aspektin ligjor me bë zgjidhje, se nuk jam për me dëmtu, sepse shumë here këto dinë me qenë dhe vdekje prurëse në disa raste. Jakup, do ti thirri inspektorët me evidentu atë çështje. Kryesues, edhe këtë ta shof cila kompani e

ka pas cune jam per me shku me i hdyri ato vendit.

z.Illir Zuka: Vetëm edhe diçka për këtë rasitn e bletave. Ai i kish fitu të gjitha, edhe me komunë edhe me gjykatë, ato duhet me u hekë, por nuk është tu pas kush me shku me i hjek. Edhe unë i kam pas diku 50 - 60 koshere bletë, dhe pasi që janë anku dhe ju ka shkaktu mos rehati rrethit i kam hjek me marrëveshje dhe mirëkuptim. Është mirë me u marrë seriozisht me këtë çështje, sepse aty dikush ka me pësu. E di që është shumë rrezik, sepse thashë edhe më heret, vet jam alergji dhe 2 herë mundem me thanë që kam lindë për së dyti. Atë ditë më kan thanë është hera e fundit që po ju thirrjm, a ki mundësi me ngritë si çështje më tha, që kur të ndodh diçka mos të thojnë që nuk e kanë ditë me thanë veç ndodhi.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Qashtu edhe mua më tha atë ditë, mirëpo tash vendmin e gjykatës duhet me intervenu policia. Faleminderit shumë! Materialin e keni marrë me kohë, rendin e ditës e keni:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Kornizen Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë 2025-2027.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2023 në vitin 2024.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin-ndryshim të Vendimit Nr. 01-110/05-670, të datës 30.04.2024 për aprovimin për bartjen e mjeteve nga një projektë në projektet tjera në shumë prej 148.376,16 Euro.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin e Vendimit me Nr.01-060/01-116, të datës 01.02.2024 për këmbimin e pronës së palujtëshme komunale me pronat e palujtshme në pronësi të pronarëve Kadri (Bislim) Emërllahu dhe Agron (Ahmet) Ahmeti.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetori të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2025.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për rendin e ditës. Pasi që nuk ka për debat e qes në votim rendin e ditës. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet rendit i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Komitetit për Politikë dhe Financa

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për procesverbalin. Pasi që nuk ka për debat e qes në votim rendin e ditës. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Kornizen Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë 2025-2027

znj.Milihate Ajeti, drejtoresha: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Korniza Afatmesme Buxhetore është një dokument përmes të cilit Ministria e Financave cakton kufijtë buxhetor për vitin vijues, të ardhmen, mbi bazën e të cilave kufi hartohet plani buxhetor i të hyrave dhe shpenzime për nje vit kalendarik. E themi këtë për arsye se, tek ne po edhe në shtetet e rajonit viti buxhetor përputhet me vitin kalendarik. Për vitin buxhetor 2025 Komuna e Vitisë do të ketë një buxhet prej 17.945.621€, që në krahasim me vitin 2024 kemi një rritje prej 7.76%. Sipas kategorive ekonomike kemi këtë buxhet: Paga dhe shtesa 9.726.436.00€, që kemi rritje për 133.502.00 €; Mallra dhe shërbime 3.172.919.00€, që kemi rritje për 540.000.00€; Komunalit kemi 300.000.00€, që kemi rritje për

5000.00 €. Subvencione dhe transferime kemi 720.000.00€, që kemi mbytur 150.000.00€. Suplenzimet kapitale kemi 4.026.266.00 €. Edhe këtu kemi rritje për 463.962.00 €. Buxheti i vitit 2025 është rritur për 1.292.429.00 €. Numri i stafit të aprovuar për vitin 2025 është 1144. Kjo është baza që ne e informojmë Komitetin për Politikë dhe Financa dhe kuvedin komunal me kufijtë buxhetor, dhe se ka fillu procesi i planifikimit të buxhetit për vitin 2025, ku ne gjatë ditëve të mujit qershor dhe muaji korrik, gusht deri në shtator do të jemi në procesin e diskutimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit sipas programeve buxhetore dhe përfshirjen e kërkesave të qytetarëve gjatë diskutimeve publike në planin e buxhetit për vitin 2025. Te hyrat vetanake për vitin 2025 planifikohen të jenë 1.270.127.00 €, që në krahasim me vitin 2024 është një rritje prej 240.625.00 €. Vlenë të theksohet se, nga ky buxhet prej 17.945.621.00€, 92.92% janë mjete nga granti qeveritar, ndërsa 7.08% janë nga të hyrat vetanake. Për informimin e juaj, buxheti sipas programeve buxhetore për vitin 2025 është: administrata 1.583.100.00 €; arsimit 6.641.436.00€; shëndetësia (QKMF) 1.383.900.00 €; shërbimet sociale 118.000.00 €. Këto janë në pika të shkurtura. Për çdo pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: E pashë diku ku thu 100 e diçka mijë euro i ki pagat dhe meditet. A është i kalkulim në këtë 100 mijë dhe rritje e 5% që është rritje e qeverisë të çdo fundviti 5% i pagave apo është i fiksum në atë 100 mishi është i stazhit të punës. Se në rast se nuk është i kalkulim ky 5%, nuk të del ky 100 mijë. Po ma merr mendja që nuk mund me dalë se, tash në rast se kemi rritje veç 100 mijë, ti the, rritje veç 100 e diçka mijë është problematike me dalë, se i kemi diku 1 mijë e 100 e diçka punëtorë.

znj.Milihate Ajeti, drejtoresha: Po e shënoj, do t'i pyes dhe do të përgjigjem.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nuk kanë të drejtë me i ngritë, se ngritja e pagave bëhet me vendim dhe nuk bënë vendim çdo vit, e lanë pezull dhe atje. Atëhere, nëse donë me rritë pagën mund me rritë më shumë se 5% që e rritë koeficientin, atëhere ta rritë ministria këtë kodë të pagave se me Ligj të Buxhetit këta e kalkulojnë vetëm 05 e stazhit të punës, që vitin e ardhshëm rritet tjetër s'kanë të drejtë me kalkulu se nuk ka vendim

z.Jakup Demiri: Në këtë formë në Kuvendin e Republikës, Ligji i Pagave është kur ka qenë atëhere me 105, tash kalon automatikisht veq me nënshkrim të ministrit bëhet 110 euro, ajo veç është e votume, ka 5% rritje në vitë

znj.Majlinda Shabani: Për këtë është me rëndësi se, meqenëse kjo ka ardhë qarkorja e parë, ish kanë mirë edhe secili sektor i drejtorive me marrë me pa a po purputhen dhe politikat, mirëpo edhe planifikimet që i kanë pas drejtoritë me këtë qarkoren e parë që na ka ardhë neve dhe mandej vërejtjet që i kemi me i dergu me kohë që me marrë dhe përgjigje me kohë. Dhe kjo është me rëndësi dhe që po besoj që ndoshta një takim i krejt drejtorëve që është, ish kanë mirë ata me diskutu para se me kalu mandej në qarkoren e dytë dhe tek tjetra, që unë kisha dashtë me pyet, është tek puna e dëgjimeve buxhetore, planifikimet që bëhen i dimë dhe prej viteve paraprake, por ndoshta ajo që po ju intereson më së shumti qytetarëve është lista e investimeve kapitale, investimet që kanë me u bë dhe problemin më të madhë komuna po e ka që po organizon dëgjime buxhetore. Ndoshta nuk po organizon në kohë të mirë planifikime, sepse gjithë ato kërkesa që janë, sepse kemi kërkesa begi shumë, këtë e dimë prej secilit fshat që vijnë kërkesat, mandej ato kërkesa me i marrë me i hartu me i harmonizu me buxhetin, me e pa mundësinë cilat janë për me hy cilat nuk janë për mos me hy këtu, mandej ne nuk po mundemi me nxjerrë në fund një listë të projekteve të investimeve kapitale që kanë me u parapa për vitin pasues, dhe qekjo kishte me qenë ndoshta vërejtja ime më e madhe, se gjithmonë po e kemi dhe në kuvend komunal. P.sh.: binë tek investimet kapitale kemi pasë të viteve të kalume, ke pas asfaltim në fshatin Lubishtë, Buzovik, Beguncë, po nuk i ke pas të specifikume ku kanë me u shtru ato asfaltime. P.sh.: nëse nëpër shkolla ose kudo dhe kësaj here është mirë që keto dëgjime ose kudo me u llogaritë koha sa më përpara me u mbajt. Disa komuna veç se kanë fillu me i mbajt dëgjimet buxhetore, ndoshta ata i kanë llogaritë ndryshe që ju nevojitet më shumë kohë. Kam parë që disa komuna veç se kanë fillu, kështu që është mirë ne edhe para se me merrë këtë afatin që në gusht, korrik planifikohen dëgjimet buxhetore, ish kanë mirë me i planifiku sa më heret. Tjetra çka është kanë te buxhetimi i përgjegjshëm gjinorë. Edhe këtu është mirë me mbajtë dëgjimin e përgjegjshëm gjinorë, sepse vitin e kalum nuk është se kemi mbajtë. Unë veç e kam përmend, përderisa e dimë që në aspekt gjinor sa i përfshinë

politika te aspektit gjimoi tane objektivat e secites drejtori qe i ka dhe politikat e tjera ato propozimi e reja qe vijne

z.Illir Zuka: Realisht ne e dimë që është në fazën e parë KAB-i, ka procedura. Një shqetësim e ngriti Majlinda për dëgjimet buxhetore. Unë e kam shqetësimin se më kanë me i mbajt dëgjimet buxhetore. Ne e dimë se sa kanë marrë pjesë qytetarët. Dhe tjetra, viteve paraprake të paktën e di që komunat tjera po edhe na kemi mbajt takime të përbashkëta, drejtoritë kanë mbajt dhe punëtori për shpërndarje të buxhetit në menyre. Te KAB-i nuk e di a është mbajt këtë vit apo jo. Secila drejtori d.m.th me i pas kërkesat e veta që mos me pas në fund. D.m.th mos me pas mungesë të bugjetit në ato çka i parashef për vitin vijues.

znj.Majlinda Shabani: Ne i kemi pasë kur i kemi mbajt dëgjimet buxhetore e dimë që kanë qenë të monitorume prej një organizates edhe në fund që ka nxjerr një raport edhe në fakt me perqindje se sa janë përfshi. D.m.th kërkesat e qyteatereve që realisht unë sa kam mujtë me i pa dhe sa kam dalë në teren nuk muj me thanë që janë përfshi. Unë po besoj që ndoshta edhe prej anes komunës ish kanë mirë, se besoj që e kanë një listë të kërkesave prej secilit fshatë që ju ka ardh dhe që nuk janë përfshi viteve të kalume dhe që mujnë me u përfshi. Tash nuk mujna na me ja lan veç fajin që me thanë nuk po dalin qyteatere në degjime buxhetore, sepse aryse për të cilën nuk dalin është pikërisht ndoshta sepse kerkesat e tyre nuk po mirren parasysh dhe nuk po perfshihen në buxhet, kështu që qekjo është e rëndësishme, se unë e kam parë me datë 27 kryetari e ka një dëgjim publik me qytetarët që ka me u mbajtë, atë e ka të rregullt që e bënë për çdo vit. Te pjesa e kërkesave që i kanë fshatrat. D.m.th kemi parë edhe prej viteve të kalume që nuk janë marrë parasysh ndoshta asnjëherë dhe për këtë ndoshta më askush nuk delë as nëpër dëgjime as me dhanë kërkesa, sepse nuk po merren parasysh tash. Ndoshta unë prej 20 apo 30 kërkesave që i kam pas, ndoshta asnjë prej tyre mujë me thanë 2-3 që janë përfshi edhe ndoshta në fshatin Lubishtë komplet investimet që janë bërë, planifikimi, ndoshta nuk ka qenë hiq në buxhet, por veç kanë hi në qat far investime që po themë asfaltim në fshtin Lubishtë, asfaltim aty dhe nuk ke mujtë me ditë sakt se ku kanë pas me shku. Kur më kanë pyet mua banorët e fshatit, a ka me u shtru filan rruga ose kjo, unë nuk mujtë me i kthy përgjigje po ose jo, se unë nuk kam parë që ka qenë e planifikume në buxhet. Tash kur po tepron buxheti po e shohim dhe pjesën tjetër.

z.Illir Zuka: Ne dhe nëpër punëtori kur kemi mbajtë takime së bashku me kryesuesin, e kemi ngritë si shqetësim mungesën e qytetarëve. Ata duhet me gjetë tani një arsytim. Është një problem shembull pse mungojnë po është edhe një ndër to. Kjo që po thotë Majlinda se, shembull ka qenë një kërkesë në Pozheran për trotuar. Në vitin 2020 ka qenë drejtor Ibrahim Rama dhe ka qenë një kërkesë e një qytetari, rruga "Haxhi Emiri" që është lagja më e banume. Tash me regjistrimin e fundit kanë dalë mbi 300 shtëpi është pa trotuar dhe kërkesa e lagjes Alidema kalon këtë se kjo në buxhet ka kalu. D.m.th është tenderi. Për fat të keq tash e kanë shpall tenderin dhe aty kish probleme. D.m.th kjo është një ndër shqetësimet dhe një pjesë e banorëve nuk dalin. Ndoshta për këtë edhe unë po e ngriti si shqetësim, se si administratorë që jam për me i qitë banorët në degjim publik ose duna me i thirë për hater

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Unë po besoj që po bisedojmë taman në frymën në të cilën me të vërtet duhet të bisedohet grupi i këshilltarëve me ekzekutivin. Majlindë, të jesh e bindur që nuk ka forum ku ka marrë pjesë e që nuk e kam ngritë këtë shqetësim, se njeriu qe 11 vite që është ballafaqu në dëgjime buxhetore, kam qenë unë e kam ngritë si shqetësim, pse e keni shti si obligim ligjor së paku 3 me i kry dëgjime buxhetore dhe në dëgjime buxhetore zakoisht përveç që ke me spjegu buxhetin, dalin edhe kërkesat. Pjesën e dytë të qytetarëve dhe në përfundim të mandatit ndesh kryeministri, ndesh kryetri i komunës kurr nuk të thojnë çka të ka thanë qytetari, por ju e matni programin e kryetarit e ka kry dhe se ka kry që unë po mendoj që këtu është një zbraztirë ligjore, që ndoshta edhe përkundër dëshires së kryetarit me i përfill qytetarët nuk mundet se nuk i thotë dikush pse nuk e ke realizu kërkesën. Më fal që po të marrë ty shembull këtu, se je prezent, nuk dua me i përgoju të tjerët, pse nuk e ke realizu kërksen e këshilltares Majlindes po e ke realizu një tjetër. Kërkush nuk i thotë, po në rast se e ka përfillë të Majlindes, i thot ti ke premtu para 4 viteve me qet program, pse nuk e ke realizu, dhe me të vërtet jemi në një situatë shumë të pa lakmueshme të cilën ju këshilltarët e dini këtë, ndërsa qyteatri nuk e dinë këtë. Nuk jam mbrojtës i Sokol Halitit, këtë

qineshi me pas te kjaft, por nuk ka kryetar qe nuk bene perpjekje maksimale ne realizimin e programit te vet, i jepë përparësi, prandaj atë që e shtrove që disa realizohen disa jo, në rastë se ato kerkesa kan qenë në program të kryetarit ai automatikisht i realizon dhe i shtin, nuk kan qenë i ikë asaj qështje veq kur ka bugjet shumë, pra me të vertet ne po bimë në pozicion të palakmueshem dhe krejt perfundimi e dinë qka thojn nuk është me rendesi se sa realizohen kerkesat është me rendesi egzekutivi me qenë transparent dhe para qytetareve me ndegju se sa ka bugjet dhe ku po e qonë i thashë atëhere delë shumë i pakuptimet me shku me tregu nuk ka nevoj se edhe unë hi në youtube hi e gjaj si shkon procedura e kuvendit dhe nuk e degjoj Hasan Aliun dhe drejtoreshen e financave , e kemi këtu që kërkohet kusht në anen tjetër nuk ka parameter mats dhe pikerisht na ndodhin ato plasaritjet pse nuk e ke shti kerkesen tonë po e injoron kshillin e fshatit, nuk është problemi injorimit por është problemi i dhanjes perparsis se nuk ka kryetar që nuk ka deshir me realizu programin e vetë ndesh ne të jetë kryeminister kushdo që të jetë deshira e tijë është me realizu atë që qytearet ja kan besu mandatin këto jan ato telashet që kemi pasë dhe sivjet, kemi pasë se nuk du me qenë shum parimor kjo është ajo me tregu të cilen me të vertet e kam ngritë shum here kur kam pas rast edhe me deputet, a keni ju problem në aspekt në nivelin qendror në aspektet të tilla kanë edhe ata se ja mësyn ndesh kryeministri edhe çdo kryetar komune me realizu programin që ka dalë fitues i zgjedhjeve, andaj nuk është që nuk po na përfillin, por është çështje që në radhë të parë ai e kqyrë programin e vet.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nëse e kqyr programin e vet, atëhere ne ta miraton buxhetin vet.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Duhet me qenë parimor. Ti ke qenë kandidat për kryetar të komunës, ke pas programin tanë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Orientimi shkon qashtu qysh po thu ti, mirëpo tani në miratim duhet pak me kalu.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Dalim aty ku e thave ti. Po këta nuk e kan ditë është një realitet. Ne sivjet i kemi qitë vetit shumë punë. Në emërtim u kanë një kërkesë edhe e kryesuesit dhe e juaja. Kemi thanë hajde po i emërtojmë do projekte që kapin shumë më të madhe edhe i kemi bë, por nuk po mund ti me emërtu, se në rast se emërton në kod, këtu rruga p.sh.: ta marrim me shtru qatje poshtë kam qenë dhe unë i kam vizitu. Kish pas rrugë atje 50/70/100 metra dhe e emërton ti me emër ti ki mi ngritë tender në vete dhe neve 6 vjet sun i shpallim ato.

z.Jakup Demiri: Unë për nja kam qenë qe 3 vjet në mandatin e parë, d.m.th nuk ka pas dëgjim buxhetor që nuk kam qenë pjesë dhe e di sakt sa përfillen dhe sa nuk përfillen. Kryetari nuk është që ka marrë pjesë shumë nëpër degjime. Naim Pira ka qenë dhe ai, unë për vete kam marrë pjesë, që përfillen listat nuk është që përfillen, se ne Smira e kemi pas një listë që i kemi dorëzu 5 kërkesa me prioritet. Hala asnjë nuk e kemi që është realizu. Ne e kemi një lumë aty, vazhdimisht kam bërë përpjekje, kurr nuk është intervenu. Mendoj që ajo lista është diku e kjo është pak keq, se unë për vete jam lodh prej dëgjimeve dhe unë nuk është më që kam marrë shumë pjesë. Nuk po du me thanë që nuk mbahen dëgjimet publike, mbahen dëgjimet publike, mirëpo nuk është edhe për krejt atë që thotë, nuk janë përfill qytetarët, kanë dhe probleme tjera, por punimet në komunën tonë, p.sh.: në Smirë kemi "Rugën e Malit", hala nuk është kry. Kena, kryetari qe 3 vjet fushatë a ende nuk është kry. Tash është nisë një rrugë tjetër ka mali, kurr nuk ka qenë prioritet i fshatit. Nuk e di se si e ka qu kryetari atë punë, pastaj po demtohen rrugët që i kemi shtru me paret tona. P.sh.: rruga te vorret teper është e dëmtume, tash edhe kjo nashta prishet. Unë e kam pyet kryetarin, kryetar, a je tu e ditë çka je tu ba. E po tha, unë nuk ju kam faj se njëhere u dashtë me kry një here atë të malit tani me kry fshatin. 2 here ma ka dhanë të njëjtën përgjigje. I thash nuk është përgjigje ajo. Ne sivjet kemi me dërgu prapë listën me prioritete dhe ta shohim tash. Tek lista e investimeve, është obligim dhe ligjor me lajmru investimet kapitale në projekte të pakten 75%, sikur është 75% e investimeve kapitale në shtator ashtu është edhe lista e investimeve kapitale.

znj.Majlinda Shabani: Edhe unë po ndërlihem te puna e kërkesave. Unë po besoj që kjo është shumë me rëndësi. E përmendi Iliri, është administrator edhe unë vet kam pas rast që me administratorin e fshatit kemi dorëzu kërkesa të vazhdueshme edhe me shkrim po edhe kshtu. P.sh.: në fshatin Lubishtë është shumë interesant, do rrugë që janë kanë kërkesë para 7-8 viteve nuk kanë arritë me u shtru. Këtë vit janë shtru. Dhe në anën tjetër e ke shembull ndriçimin, gjysma e fshatit ka ndriçim, gjysma nuk ka, që nëse e llogaritë komplet ndoshta as 15 mijë euro nuk ish bë krejt ajo pjesë që nuk

ka punë. Është njëka shumë me e vogël për komunën që është me e përbanusime, po qytetarëve ju hynë begi shumë në punë, edhe te kjo është ajo të paknaqësitë që i ka, se dorën në zemër unë ndoshta po të kuptoj edhe ty nënkryetar.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Dalim ku po ka paknaqësi. A nuk po të vjen keq prej këtyre këshilltarëve me folë për investime në Lubishtë. Nuk ka sen në Lubishtë që nuk është bërë. Çka kemi investu në Lubishtë e kemi tepru, duhet me të ardh keq edhe prej Pozheranit.

znj.Majlinda Shabani: Këto 2 muajt e fundt keni investu në Lubishtë.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Me kanalizim me ujësjellës.

znj.Majlinda Shabani: Ama qysh e keni bërë kanalizimin. Puna e rrugës është nis qysh në kohë fushate, po nuk u kry deri tash. Ajo ka mujtë me u kry qysh moti.

z.Illir Zuka: Majlindë, "Lagjja Zuka" është 2 here më e madhe se Lubishta, investimet janë 200% më të mëdha në Lubishtë se në krejt Pozheranin.

znj.Majlinda Shabani: Është bërë njëfar praktike te ne në Komunën e Vitisë. Ne jemi në vitin e fundit p.sh.: të zgjedhjeve dhe ne kemi parë që në vitin e parafundit intenziteti i punëve shtohet në teren. P.sh.: puna e asfaltimit nënkryetar, e kemi parë dhe jemi tu e pa vazhdimisht pse nuk është shtrur para 2 viteve.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Sivjet është kanë e parapame.

znj.Majlinda Shabani: Keni thanë ka me u kry, bile ka me u kry në kohë fushate, që ka pas me u kry po nuk është kry. Unë nuk e kam këtu për me diskutu dhe me bërë politikë. Shumë lehtë kryetari mundet me zgjidhë këtë problem. Paraprakisht mundet me thanë bani 5 prioritete ti që i ke si fshat. Puna e ujit është në secilin fshat që nuk është zgjidhë, puna e asfaltimit të rrugëve secili fshat i ka nga 2 rrugë më të rëndësishme me i asfaltu.

z.Illir Zuka: 50% të buxhetit të komunës e merrni 2 fshatra.

znj.Majlinda Shabani: KE pas fshatin Buzovik që ka shku ju ka shtrur asfalti. Ata që janë kanë me LDK, ata që kanë qenë Vetëvendosje komplet një lagje nuk e ka shtrur.

z.Illir Zuka: Ti po e banalizon debatin.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kjo temë ka mujtë me u diskutu jashtë rendit ditës. Ne jemi tu diskutu për kornizë buxhetore. Në kornizën buxhetore nuk mundesh shumë me bërë ndryshime, se janë formulat që t'i orientojnë parat. Ndahen mjetet, shembull investimet kapitale kenë 4 milion, tash ti këto 4 milion duhet me fillu pasi të miratohet kur të lejohet korniza dytë buxhetore fillojnë nëpër fshatra dhe orientohet korniza buxhetore, fillojnë projektet ka kanë me shku. Qat here është kjo temë që je tu e diskutu. Ne tash jemi tu folë për 4 milion, për tjerat ne asnjë cent nuk e dimë ka kemi me i qu. Ne ja kemi dërgu listen ministrisë, por kur na e ka kthyer neve na u kan hjek 20 punëtorë prej listave në paga. Tash nuk e dimë sa kanë me na e zvoglu numrin e punëtorëve, se ka ra numri i nxanësve. Tash kur të vjenë korniza e dytë buxhetore, atëhere ne e shohim që kemi me pas problem edhe me stazh, kemi me i diskutu dhe temat tjera kanë me u zvoglu vendet e punës, sepse ka ra popullësia. Buxheti ndahet me numër të popullsisë kemi dalë 10 mijë banor më pak. Ndoshta e merr numrin e sivjet që ka dalë ta ndan buxhetin me këtë numër menjëhere prej 4 milion në 3 milion na binë investimet kapitale, mirëpo ky është si orientim i parë, si orientim i parë në bazë të drejtorive, në bazë mekanizmave komunal, në bazë të formulave që janë.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: sivjet e kanë marrë ish numrin e banorëve, qekjo formulë është, vitin e ardhshëm nuk e ke. Tash Fushë Kosova ti lypë, thotë më ke dëmtu që sa kohë, tash jam 70 mijë banorë, kthema buxhetin.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: D.m.th orientimi është qëkjo. Tani këtë pjesën që je tu kërku Majlindë, duhet me hy te pjesa e dytë. Ne parimisht 2 dëgjime buxhetore duhet me i realizu Kuvendi. Nëse keni bërë ndonjë dëgjim tashti, se Kuvendi ka për obligim me organizu 1 dëgjim buxhetor, nëse donë para seancës, një ka me organizu pasi të vjen korniza dytë para seancës që miratohet buxheti i ka kuvendi, ndërsa qeverisja i ka tjera, që janë të ndame me ligj, janë të përcaktume. Prej kur kam ardh unë i kemi mbajtur ka 2 rregullisht. Problem kemi pas që këshilltarët nuk na kanë dalë asnjë.

z.Illir Zuka: Fillimisht unë kur e morra fjalën e ceka se është hapi parë. Janë kanë procedurat që kemi me i kalu. Mos të ja nisim prej fillimi, janë procedura që nuk mundemi me i ikë. Po dashta me u lidhë, d.m.th te kryetari. Ne e dimë që secili konkuron për një projekt 4-vjeçar që ka me investu e

ka një pjesë 50-70% të buxhetit, po një pjesë gjatë të buxhetit që realisht duhet me u korrigjuar me asamble, me kshillat e fshatrave. Cila është më e nevojshme. Ne e dimë që dalin disa që me urgjencë ke me i kry. Ti ki me lan diçka keq në qoftse e ke parapa 100%.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Debat, projekti bëhet në formë të pergjithshme. Ne krejt njëjtë i kemi folë. Asfaltimi, ujësjellësi, te 3 njëjtë kemi folë, se uji ka qenë problemi kryesor dhe nuk jemi tu bë bash kurgja. Për ujë bile me më ngu mu 50% e kishim qu në ujë, bile ju kishim bë mirë qytetarëve. Nëse ka ndonjë çështje konkrete për këtë pikë ju ftoj për debat. Pasi që nuk ka për debat, kërkoj që të miratohet kjo pikë të shkoj në Kuvend. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim kjo pikë shkon për kuvend.

Si pikë e tret e rendit të ditës:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2023 në vitin 2024

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kjo është e vonume, mirëpo ata kanë pas me bë një vendim që këto pa vendim që kanë qenë i kam kërku Beratit, që këto të hyra vetanake që nuk shpenzohen në vitin paraprak çdo here vitin e tretë duhet me u bartë. Edhe vitin e kalum jan shty deri në muajin e 6-të. Këto barten në kodet ku kanë mbetë, nuk barten në kode tjera, nuk ndryshohet kodi. Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat, a jeni që kjo pikë të shkoj në Kuvend. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim shkon në kuvend.

Si pikë e katert e rendit të ditës:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin-ndryshim të Vendimit Nr. 01-110/05-670, të datës 30.04.2024 për aprovimin për bartjen e mjeteve nga një projekt në projektet tjera në shumë prej 148.376,16 euro

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ky propozim vendim na u ka kthy në rregull. Ne e kemi miratu, u kthy në rregull, po është bërë një gabim prej drejtorisë. Vetëm numri i fundit i kodit ka ndryshu, e kanë bë gabim prej Zyrës Ligjore, kanë thanë përmirësone, mirëpo këta nuk kanë marr guxim me e përmirësu. Mua ma kanë ofru në kuvend, unë kam thanë ma dergoni plotësim ndryshimin, sepse në momentin kur qohet gishti unë asnjë germë nuk kam të drejtë me ndryshu dhe nuk e bëjë. Për këtë kemi shku veç plotësim ndryshim. Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të shkoj në kuvend kjo pikë? Pra, nga të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim shkon në kuvend.

Si pikë e pestë e rendit të ditës:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin e Vendimit me Nr. 01-060/01-116, të datës 01.02.2024 për këmbimin e pronës së palujtëshme komunale me pronat e palujtshme në pronësi të pronarëve Kadri (Bislmi) Emërllahu dhe Agron (Ahmet) Ahmeti

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nëse ju kujtohet, ky propozim vendim ka kalu në janar në kuvend. Ministria na e ka kthy që nuk është i plotfuqishëm pa e dhanë vlerësimin vetë Ministria e Financave, se keni bë një hapë para vlerësimit dhe ky vendim ka mbet pezull dhe ka ardh vlerësimi i Ministrisë së Finacave.

z.Illir Zuka: Edhe kur ka ardhë në janar unë kam mendu që ka qenë si pikë e ndjeshme me u kry. Realisht kanihere po i kalojmë procedurat, nuk po i ndjekim taman siç duhet. Unë tash jam shumë i informum se kanë ardh 2 here prej Ministrisë së Financeve, e kanë bërë matjen e kanë bërë krejt vlerësimin dhe kanë ardh me një raport që tash është në rregull për me kalu. Përndryshe, u kanë i informum për këtë edhe kryesuesi.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të shkoj në kuvend kjo pikë. Pra, nga të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim shkon në kuvend.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës.

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetori të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2025

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: D.m.th, çdo vit e kemi ne me bë planin e kuvendit komunal, ndërsa plani i kuvendit ne e kemi qu, zakonisht kryesuesi e udhëheq. Ka një përfaqësues prej partive, po e kemi shti dhe prej Aleancës, sekretari i kuvendit dhe një perfaqësues i shoqërisë civile. Plani zakonisht është i njëjtë, por mundemi me shti një pikë të re për kuvendin. Për vitin 2025 ju permbahemi dhe kuotes gjinore, i bajmë në kuvend. Kjo është procedurë, tani del në diskutim publik. Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat, a jeni që të shkoj në kuvend kjo pikë? Pra, nga të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abtenim, shkon në kuvend.

Me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| | | | |
|--|------------|------------------|-------------------|
| Pranuar - Prindjeto Më/Dena 12-07-2024 | | | |
| Nr. i organit Org. broj | Numri/Broj | Shtetë Prilog | Vlera Vredësof |
| 02- | 402 | /01- | 961 |



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA - MUNICIPAL VITINA



Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-qershor 2024

Viti 12.07.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA - MUNICIPAL VITINA



DREJTORIA E FINANCEVE

| | |
|-----------------------|--|
| Data/Datum/Date | 12.07.2024 |
| Nr/Br. | |
| Për/Za/To | Kuvendin e Komunës, Komitetin për Politikë dhe Financa |
| Përmes/Preko/Through | Sokol Haliti, Kryetar i Komunës |
| Nga/Od/From | Milihate Ajeti Drejtor i Drejtoris për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim |
| Lënda/Predmet/Subject | Pasqyrat Financiare për periudhën janar-qershor 2024 |

Bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin mbi Financat Lokale si dhe Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë paraqesim pasqyrat financiare të organizatës sonë buxhetore (657) për periudhën janar-qershor 2024 përfshirë të hyrat vetanake të realizuara si dhe shpenzimet buxhetore për të gjitha kategoritë ekonomike.

Të hyrat

Gjatë periudhës janar – qershor 2024 janë inkasuar gjithësej të hyra vetanake në vlerë prej 480.306,73€, shkalla e inkasimit, duke u bazuar në planifikimin vjetor është 46,65%, ndërsa krahasuar me të hyrat për periudhën janar – qershor të vitit 2023 të hyrat e vitit 2024 janë me të vogla për 210.669,16 €

Shpenzimet Buxhetore

Buxheti i Alokuar për periudhën janar – qershor të vitit 2024 nga fondet burimore: Granti qeveritar, të hyrat vetanake, dhe donacionet janë: 12.815.069,21€, ndërsa shpenzimet janë: 11.661.824,46€, shkalla e ekzekutimit të buxhetit për periudhën janar- qershor 2024 është 91,00% në krahasim me Alokimet për të gjitha programet dhe kategoritë ekonomike.

Në vazhdim të këtyre pasqyrave në mënyrë tabelare do të paraqesim shpenzimet buxhetore, duke i specifikuar sipas burimeve të financimit, programeve dhe kategorive Ekonomike.

Buxheti i Aprovuar, Alokuar dhe i shpenzuar per te Gjitha programet buxhetore - janar-Qershor 2024

| Aprovim | | | | | | | |
|----------------------------|----------------|---------------|---------------|---------------|-----------------------|----------------------|--------------|
| Kateg.&Ekonomik | | | | | | | |
| | e | Aprovime 10 | Aprovime 21 | Aprovimet 22 | Aprovimet Donacionet | Totali i Aprovimeve | |
| 1 | Pagat &Shtesat | 9,592,933.89 | 0.00 | 0.00 | 25,281.90 | 9,618,215.79 | |
| 2 | Mall.&Sherbime | 2,453,828.00 | 179,091.00 | 7,840.58 | 22,088.74 | 2,662,848.32 | |
| 3 | Komunali | 295,000.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 295,000.00 | |
| 4 | Subvencione | 360,000.00 | 210,000.00 | 9,992.35 | 119,234.05 | 699,226.40 | |
| 5 | Kapitale | 2,921,928.00 | 640,411.00 | 115,165.03 | 268,957.69 | 3,946,461.72 | |
| | | 15,623,689.89 | 1,029,502.00 | 132,997.96 | 435,562.38 | 17,221,752.23 | |
| Alokimet | | | | | | | |
| Kateg.&Ekonomik | | | | | | | |
| | e | Alokimet 10 | Alokimet 21 | Alokimet22 | Alokimet Donacionet | Totali i Alokimeve | |
| 1 | Pagat &Shtesat | 7,489,069.13 | 0.00 | 0.00 | 25,281.90 | 7,514,351.03 | |
| 2 | Mall.&Sherbime | 1,524,081.29 | 138,426.37 | 7,840.58 | 22,088.74 | 1,692,436.98 | |
| 3 | Komunali | 170,450.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 170,450.00 | |
| 4 | Subvencione | 193,000.00 | 71,000.00 | 9,992.35 | 119,234.05 | 393,226.40 | |
| 5 | Kapitale | 2,448,376.28 | 212,105.80 | 115,165.03 | 268,957.69 | 3,044,604.80 | |
| | | 11,824,976.70 | 421,532.17 | 132,997.96 | 435,562.38 | 12,815,069.21 | |
| Te paalokuara | | | | | | | |
| Kateg.&Ekonomik | | | | | | | |
| | e | Alokimet 10 | Alokimet 21 | Alokimet22 | Alokimet Donacionet | Totali i Alokimeve | |
| 1 | Pagat &Shtesat | 2,103,864.76 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 2,103,864.76 | |
| 2 | Mall.&Sherbime | 929,746.71 | 40,664.63 | 0.00 | 0.00 | 970,411.34 | |
| 3 | Komunali | 124,550.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 124,550.00 | |
| 4 | Subvencione | 167,000.00 | 139,000.00 | 0.00 | 0.00 | 306,000.00 | |
| 5 | Kapitale | 473,551.72 | 428,305.20 | 0.00 | 0.00 | 901,856.92 | |
| | | 3,798,713.19 | 607,969.83 | 0.00 | 0.00 | 4,406,683.02 | |
| Shpenzimet | | | | | | | |
| Kateg.&Ekonomik | | | | | | | |
| | e | Shpenzimet 10 | Shpenzimet 21 | Shpenzimet 22 | Shpenzimet Donacionet | Totali i Shpenzimeve | % shpenzimit |
| 1 | Pagat &Shtesat | 7,472,308.36 | 0.00 | 0.00 | 6,852.90 | 7,479,161.26 | 99.53% |
| 2 | Mall.&Sherbime | 1,352,550.48 | 126,674.11 | 6,335.00 | 0.00 | 1,485,559.59 | 87.78% |
| 3 | Komunali | 155,824.07 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 155,824.07 | 91.42% |
| 4 | Subvencione | 126,444.07 | 67,130.00 | 5,750.00 | 119,219.74 | 318,543.81 | 81.01% |
| 5 | Kapitale | 1,786,266.42 | 180,487.85 | 109,313.96 | 146,667.50 | 2,222,735.73 | 73.01% |
| | | 10,893,393.40 | 374,291.96 | 121,398.96 | 272,740.14 | 11,661,824.46 | 91.00% |
| Diferenca Alokim-Shpenzim | | | | | | | |
| Kateg.&Ekonomik | | | | | | | |
| | e | Shpenzimet 10 | Shpenzimet 21 | Shpenzimet 22 | Shpenzimet Donacionet | Totali i Shpenzimeve | |
| 1 | Pagat &Shtesat | 16,760.77 | 0.00 | 0.00 | 18,429.00 | 35,189.77 | |
| 2 | Mall.&Sherbime | 171,530.81 | 11,752.26 | 1,505.58 | 22,088.74 | 206,877.39 | |
| 3 | Komunali | 14,625.93 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 14,625.93 | |
| 4 | Subvencione | 66,555.93 | 3,870.00 | 4,242.35 | 14.31 | 74,682.59 | |
| 5 | Kapitale | 662,109.86 | 31,617.95 | 5,851.07 | 122,290.19 | 821,869.07 | |
| | | 931,583.30 | 47,240.21 | 11,599.00 | 162,822.24 | 1,153,244.75 | |
| Diferenca Aprovim-Shpenzim | | | | | | | |
| Kateg.&Ekonomik | | | | | | | |
| | e | Shpenzimet 10 | Shpenzimet 21 | Shpenzimet 22 | Shpenzimet Donacionet | Totali i Shpenzimeve | |
| 1 | Pagat &Shtesat | 2,120,625.53 | 0.00 | 0.00 | 18,429.00 | 2,139,054.53 | |
| 2 | Mall.&Sherbime | 1,101,277.52 | 52,416.89 | 1,505.58 | 22,088.74 | 1,177,288.73 | |
| 3 | Komunali | 139,175.93 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 139,175.93 | |
| 4 | Subvencione | 233,555.93 | 142,870.00 | 4,242.35 | 14.31 | 380,682.59 | |
| 5 | Kapitale | 1,135,661.58 | 459,923.15 | 5,851.07 | 122,290.19 | 1,723,725.99 | |
| | | 4,730,296.49 | 655,210.04 | 11,599.00 | 162,822.24 | 5,559,927.77 | |

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit për të gjitha njësit buxhetore

| Nr | Emërtimi | Buxheti i aprovuar | Alokimet e buxhetit | Shpenzimet | Buxheti i pa shpenzuar | Alokimi i pa shpenzuar | % |
|----|----------------------------|------------------------|------------------------|------------------------|------------------------|------------------------|---------------|
| 1 | Kompensimi i të punësuarve | 9,618,215.79 | 7,514,351.03 | 7,479,161.26 | 2,139,054.53 | 35,189.77 | 99.53% |
| 2 | Mallra dhe shërbime | 2,662,848.32 | 1,692,436.98 | 1,485,559.59 | 1,177,288.73 | 206,877.39 | 87.78% |
| 3 | Subvencione | 699,226.40 | 393,226.40 | 318,543.81 | 380,682.59 | 74,682.59 | 81.01% |
| 4 | Komunali | 295,000.00 | 170,450.00 | 155,824.07 | 139,175.93 | 14,625.93 | 91.42% |
| 5 | Shpenzime kapitale | 3,946,461.72 | 3,044,604.80 | 2,222,735.73 | 1,723,725.99 | 821,869.07 | 73.01% |
| | Gjithesëjt | 17,221,752.23 € | 12,815,069.21 € | 11,661,824.46 € | 5,559,927.77 € | 1,153,244.75 € | 91.00% |

Shpenzimet për të gjitha njësit buxhetore

| Kodi | Përshkrimi | Shuma |
|-------|--|---------------------|
| 11111 | Paga neto | 3,680,243.94 |
| 11121 | Tatimi në te ardhurat personale | 267,290.71 |
| 11131 | Kontributi pensional - punëtorit | 220,409.47 |
| 11151 | Sindikata | 11,742.14 |
| 11152 | Odat Profesionale | 4,262.04 |
| 11211 | Pervoja e punes | 180,675.04 |
| 11311 | Kontributi pensional - punëdhënsit | 220,409.47 |
| 11411 | Shtesa e veçant për te zgjedhurit | 15,407.94 |
| 11431 | Kujdestaria puna gjate nates dhe puna jashte orarit te punes | 35,856.14 |
| 11611 | Shtesat tranzitore | 2,734.45 |
| 11900 | Vendimet gjyqesore | 2,840,129.92 |
| | Totali i pagave | 7,479,161.26 |
| 13130 | Transporti per udhetime zyrtare brenda vendit | 13,233.20 |
| 13140 | Transporti per udhetime zyrtare jashte vendit | 4,094.48 |
| 13141 | Para xhepi/meditje per udhetime zyrtare jashte vendit | 1,137.00 |
| 13142 | Akomodimi per udhetime zyrtare jashte vendit | 778.50 |
| 13143 | Shpenzime e tjera per udhetime zyrtare jashte vendit | 454.83 |
| 13210 | Energjia elektrike | 126,293.83 |
| 13220 | Sherbimet e ujeshellsit dhe kanalizimit | 6,045.45 |
| 13230 | Mbeturinat | 20,281.48 |
| 13250 | Telefonia Fikse | 3,203.31 |
| 13310 | Interneti | 2,496.00 |
| 13320 | Telefonia Mobile | 10,608.25 |
| 13430 | Sherbime te ndryshme shendetesore | 233,831.69 |
| 13440 | Sherbimet keshilldhense dhe profesionale | 65,427.50 |
| 13445 | Sherbimet e veqanta - konsulentit dhe kontraktor individual | 27,799.90 |
| 13450 | Sherbimet e shtypjes / printimit | 4,447.07 |
| 13460 | Sherbime kontraktuese tjera | 43,751.91 |

| | | |
|-------|---|------------------------|
| 13470 | Sherbimet teknike | 7,343.18 |
| 13480 | Shpenzimet e anetaresimit | 7,048.05 |
| 13501 | Mobilje | 11,550.00 |
| 13503 | Komjuteret | 563.00 |
| 13504 | Pajisje tjera te teknologjis informative dhe te komunikimit | 8,346.30 |
| 13509 | Pajisje tjera | 225,925.94 |
| 13510 | Blerja e librave dhe veprave artistike | 20,860.50 |
| 13511 | Pajisjet sportive | 2,721.00 |
| 13610 | Furnizimet per zyre | 30,266.35 |
| 13611 | Furnizimi me dokumente blanko | 2,719.99 |
| 13620 | Furnizimi me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) | 16,235.36 |
| 13630 | Furnizimet mjekesore | 62,978.41 |
| 13640 | Furnizimet e pasirimit | 21,553.68 |
| 13650 | Furnizimi me veshembathje | 975.00 |
| 13720 | Naftë per ngrrohje qendrore | 15,925.44 |
| 13760 | Drute dhe prodhimet e drurit per ngrrohje | 86,047.50 |
| 13780 | Derivatet per automjete, gjenerator dhe makineri | 20,770.63 |
| 13950 | Regjistrimi i automjeteve | 1,325.00 |
| 13951 | Sigurimi i automjeteve | 3,301.34 |
| 13953 | Sigurimi i nderesave dhe te tjera | 2,772.00 |
| 13954 | Kontrollimi teknik i automjeteve | 410.00 |
| 14010 | Mirembatja dhe riparimi i automjeteve | 20,766.00 |
| 14022 | Mirembatja e nderesave administrative dhe afariste | 159,426.18 |
| 14023 | Mirembatja e nderesave arsimore | 180.96 |
| 14032 | Mirembatja e rrugeve lokale | 166,538.45 |
| 14040 | Mirembatja e teknologjis informative dhe te komunikimit | 4,899.70 |
| 14050 | Mirembatja e mobiljeve dhe paisjeve | 23,973.10 |
| 14060 | Mirembatja rutinore | 15,280.00 |
| 14220 | Botimet e publikimeve | 3,340.00 |
| 14230 | Shpenzimet per informim publik | 13,527.45 |
| 14310 | Kompensimi i perfaqesimit brenda vendit | 25,812.95 |
| 14410 | Vendimet gjyqesore | 94,115.80 |
| | Totali për shërbimeve maltra dhe komunali | 1,641,383.66 |
| 200 | Subvencionet dhe transfere | 318,543.81 |
| | Totali i subvencioneve | 318,543.81 |
| 300 | Investime kapitale | 2,212,735.73 |
| 34000 | Pagesat sipas vendimeve gjyqesore | 10,000.00 |
| | Totali i investimeve kapitale | 2,222,735.73 |
| | Gjithsej shpenzimet | 11,661,824.46 € |

Zyra e Kryetarit
Kodi 16033

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

| Nr | Emërtimi | Buxheti i aprovuar | Alokimet e buxhetit | Shpenzimet | Buxheti i pa shpenzuar | Alokimi i pa shpenzuar | % |
|----|----------------------------|---------------------|---------------------|---------------------|------------------------|------------------------|---------------|
| 1 | Kompensimi i të punësuarve | 361,500.00 | 209,654.71 | 209,654.71 | 151,845.29 | 0.00 | 100.00% |
| 2 | Mallra dhe shërbime | 141,362.16 | 92,697.53 | 79,394.43 | 61,967.73 | 13,303.10 | 85.65% |
| 3 | Subvencione | 124,927.27 | 107,927.27 | 97,410.00 | 27,517.27 | 10,517.27 | 90.26% |
| 4 | Komunali | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | #DIV/0! |
| 5 | Shpenzime kapitale | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | #DIV/0! |
| | Gjithsej | | | | | | |
